

Kufij Tri rrëfime për lirinë të thyer



MËSOJMË NGA E KALUARA



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

KUFIJ TË THYER

Tri rrëfime për lirinë

Një botim për ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare

Shkroi: **ROVENA RROZHANI**

Ilustruar nga: **ANILA ZAJMI-KATANOLLI**

Koordinatorë e botimeve AIDSSH

Dr. Ornela Arapi

Kryetar i grupit të punës

Gjergji Marku

Redaktore letrare

Elona Baçi

Mblodhën dëshmitë

Bukurie Sokoli

Anila Zajmi-Katanolli

Regjistroi dëshmitë

Dorian Zanaliu

Ndihmuan

Nertila Seitaj

Elona Baçi

Bukurie Sokoli

Luan Ismaili

Design

HL Branding

Shtypshkronja

Title title tile

Teksti i librit u miratua nga ASCAP. Konsulent pedagogjik: Astrit Dautaj

Koordinoi procesin: Dr. Brunilda Çërraga



Ngjarjet në këtë libër janë rrëfim artistik i bazuar në histori të vërteta, mbështetur në dëshmitë audiovizuale të dhëna nga ish-të dënuarit politikë për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) si dhe në dokumentet e arkivit të këtij institucioni.

Për të vizituar arkivin dhe mjediset e AIDSSH, kërkoni në shkollën tuaj që të kontaktojnë në: **info@autoritetidosjeve.gov.al**

Sot ti mund t'i kalosh kufijtë e shtetit ku jeton. Me familjen tënde sot ti mund të lëvizësh jashtë Shqipërisë për të studiuar, për të punuar apo për të pushuar. Mund të udhëtosh me avion, me anije apo me makinë; teksa udhëton, mund të lësh pas kufijtë e vendit tënd për të parë të tjera vende të panjohura. Mund të ndihesh i gëzuar që po ikën dhe përsëri i gëzuar që po kthehesh në atdhe. Mund të rrish sado gjatë, por kur të merr malli, mund të vish sërish në vendlindje, sepse çdo njeri ka të drejtën e lirisë së lëvizjes.


Por, vetëm disa dekada më parë **lëvizja e lirë** ishte e ndaluar për shqiptarët. Shqipëria e viteve 1944-1990 ishte një vend i izoluar, me kufij të mbyllur dhe i rrethuar me tela me gjemba. Askush nuk mund të lëvizte i lirë jashtë kufijve të vendit. Regjimi diktatorial, pas Luftës së Dytë Botërore, filloi menjëherë eliminimin e kundërshtarëve politikë dhe e të gjithë atyre që i konsideronte “armiç të popullit”



duke shkelur të drejtat themelore të njeriut. Jeta e mijëra shqiptarëve u vu në rrezik. Kjo gjendje detyroi shumë prej tyre të kërkonin një **rrugë shpëtimi** nga diskriminimi, përndjekja, torturat dhe ekzekutimet me vdekje.

Mijëra vetë provuan ta kalonin kufirin tokësor të rrethuar nga telat e lartë me gjemba apo detet, liqenet e lumenjtë e ruajtur me prozhektorë dhe forca kufitare. Shumë prej tyre u vranë, të tjerë u arrestuan dhe vuajtën dënimin në burgje. Disa të tjerë ia dolën që të kalonin në anën tjetër të kufirit dhe të nisnin një jetë të re. Çdo shqiptar që arriti të thyente kufijtë që mbylli diktatura, u kthye në një **shembull qëndrese**, mbijetese dhe revolte ndaj regjimit totalitar.

Në këtë libër ju rrëfejme tri nga shumë historitë e arratisjeve drejt lirisë, tri histori me fate të ndryshme. Ato vijnë si mësim nga e kaluara e cila duhet njohur.



-HISTORIA 1-

NJË VARKË DREJT LIRISË

(mbështetur në dëshminë e Et'hem Fezollarit)

3 KORRIK 1975

Natë. Një varkë e sajuar rrëshqiste pa zhurmë në liqen, e mbështjellë nga errësira e plotë. Mbi mushamanë e përshtatur si dysheme udhëtonin 16 njerëz, mes tyre fëmijë dhe gra. Një udhëtim i pazakontë drejt lirisë do të niste atë mbrëmje vere në kufirin ujqor të Shqipërisë.

TRI JAVË MË PARË

Në bodrumin e një shtëpie në Pogradec tre vëllezër kishin filluar zbatimin e një plani. Ata kishin grumbulluar pëlhura kundër ujit, tela dhe dërrasa. Punonin natën, kur të gjithë flinin, duke bërë kujdes të mos përdornin asnjë gozhdë që të shmangnin zhurmën.

- Çfarë po bëni? - pyesnin me kërshtëri gratë e tyre gjatë ditës kur shikonin lëvizjet e tyre të pazakonta.

- Një makineri për të endur coha, - u përgjigjeshin ata.

Nuk flisnin nga **frika** se mund t'u zbulohet plani. Vetëm nëna dhe motra e dinin të vërtetën. Pasi punuan çdo natë për tri javë, arritën të ndërtonin një varkë. Drurët e sharruar i kishin lidhur me tela metalikë në skaje për ta bërë më të fortë dhe të qëndrueshme ndaj peshës. Vëllezërit përlogaritën që struktura që ata e quajtën varkë, të mbante të gjithë familjen. Pasi e ndërtuan, e çmontuan sërish. Pjesët i fshehën në pyll dhe në kala. Prej andej do t'i çonin afër bregut të liqenit pak orë përpara se të hynte data 3 korrik. Aty do t'i montonin sërish në **fshehtësi të plotë**.



AZK

'24

Tanimë të rriturit e mësuan se atë mbrëmje korriku do të niseshin për të kaluar në anën tjetër të liqenit. U ndanë në grupe dhe morën rrugë të ndryshme për të shkuar drejt vendit ku ishte fshehur varka. Në këtë mënyrë nuk do të binin në sy të askujt që mund të diktonte planin e tyre dhe të lajmëronte policinë. Kjo do të kishte qenë me pasoja shumë të rënda për jetën e tyre. Ndërkohë, shumë pranë tyre, në vilën qeveritare në Pogradec, **diktatori**, si çdo verë, bënte pushimet i ruajtur nga ushtarë.

TRE MUAJ MË PARË

Familja jetonte në bodrum sepse shtëpinë ua kishin marrë kur i kishin internuar të gjithë, shumë vite më parë. Arsyeja e internimit ishte **arratisja** e babait të tyre. Siç ndodhte në këto raste familja e tij do të vuante pasojat. Gruaja e tij, tre djemta, 8 dhe 4 vjeç, më i vogli disamuajsh, si dhe vajza 2 vjeç, të gjithë u internuan fillimisht në një kamp në Kodër-Kamëz në Tiranë.

Kampet e internimit ishin ngulitur thellë në mendjen e Et'hemit, djalit të dytë të familjes, i cili ishte vetëm 4 vjeç kur ndjeu për herë të parë vuajtjen. Kur u kthyen sërish në Pogradec, në shtëpinë e tyre regjimi kishte strehuar familje të tjera. Për ata kishte mbetur vetëm bodrumi që kishte shërbyer për bagëtitë. Nëna kishte çarë murin dhe kishte sajuar një dritare duke puthitur xhamin me baltë.

Jeta ishte bërë e padurueshme nga përndjekjet e spiunëve për çdo lëvizje apo fjalë të thënë, nga **lufta e klasave** që kishte ndarë popullin dhe i kishte kthyer njerëzit kundër njëri-tjetrit. Familja ishte zhytur në varfëri të thellë sepse nuk u jepnin as punë dhe as triska për të marrë ushqime, si për të gjithë njerëzit e tjerë. Familja e tyre konsiderohej armike e popullit.

Të tre vëllezërit e kuptuan se fati i tyre në të ardhmen do të ishte sërish burgu ose internimi. Kështu vëllezërit filluan të mendonin se si të arratiseshin për të gjetur lirinë.

- Çfarë po bën me atë kamerdare? – e kishte pyetur e ëma djalin e tretë.

Ata menduan të kalonin kufirin nga liqeni i Ohrit për të arritur në atë pjesë të Jugosllavisë që sot është Maqedonia e Veriut. Kishin vendosur të arratiseshin me not, por meqenëse vëllai i madh nuk dinte të notonte mirë, kishin marrë një kamerdare makine. Syrit të nënës nuk i shpëtoi ky detaj.



Ajo e kuptoi menjëherë se çfarë po përgatishnin djemtë e saj.

- **Do të ikim** të gjithë. Nuk mund të lini gratë dhe fëmijët të vuajnë këtu. Ju e dini që ata që mbeten këtu, internohen dhe keqtrajtohen, – u tha ajo prerazi.

Pas kësaj ata filluan të mendonin për mjetin lundrues që u duhej të ndërtonin, me të cilin do të bënin udhëtimin më të vështirë të jetës së tyre plot 16 vetë, më i vogli nga të cilët ishte një foshnje disamuajshe.

Për t'u arratisur zgjodhën zonën më të pambrojtur të liqenit. Por ajo ishte më e vështira, në një breg të thepisur dhe me gurë nën ujë që mund të çanin mushamanë. Ndërsa prozhektori që ndriçonte zonën, për të fat të mirë nuk ndizej prej kohësh.

30 VJET MË PARË

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, disa vende të Europës Juglindore mes të cilave edhe Shqipëria, vendosën **sistemin njëpartiak** të qeverisjes. Partia ishte vetëm një dhe ajo drejtonte shtetin. Askush nuk kishte të drejtë të kundërshtonte partinë. Kushdo duhet të bënte siç thoshte partia. Ky sistem në Shqipëri u zbatua në mënyrë më të ashpër. Menjëherë pas luftës, partia shpalli armiq të popullit të gjithë kundërshtarët e saj, duke i dënuar me gjyqe speciale, me burgime, internime dhe dënime me vdekje...

Babai i familjes Fezollari, kishte qenë partizan dhe pas mbarimit të luftës ishte emëruar kryetar i qytetit të Pogradecit. Padrejtësitë që u bënë nga regjimi e prekën dhe ai filloi të kritikonte partinë. Shumë shpejt u shkarkua nga detyra, doli para gjyqit dhe u dënua me pushkatim pikërisht për fjalët që kishte thënë. Duke shpëtuar nga ekzekutimi, ai vendosi të arratisesh. Familjet e atyre që dënoheshin, shpalleshin gjithashtu **armike të popullit** dhe jo vetëm që internoheshin apo burgoseshin, por edhe liheshin në kushte jetese të mjerueshme duke ua bërë mbijetesën thuajse të pamundur. **Lufta e klasave** mes njerëzve erdhi dhe u bë më e ashpër me kalimin e viteve. Kushdo që konsiderohej armik i popullit, përndiqej gjatë gjithë kohës nga Sigurimi i Shtetit dhe mënjanoheshin nga njerëzit, të cilët ca nga frika dhe ca se i konsideronin vërtet armiq, nuk u afroheshin. Et'hemu ishte fëmijë kur filloi ta ndiente peshën e rëndë të **përbuzjes** dhe të **veçimit** nga të tjerët.

SËRISH MË 3 KORRIK 1975

Ishin çastet e fundit në shtëpi për familjen Fezollari. Të gjithë ndiheshin si mbi gjemba. Do të niseshin drejt një udhëtimi, fundi i të cilit nuk dihej. Askush nuk duhet ta mësonte atë që do të bënin, në të kundërt plani i tyre do të dështonte.

Dhe nëse kjo do të ndodhte, askush nuk do t'i shpëtonte **ndëshkimit** të egër të regjimit. Pas disa orësh mbretëroi errësira pa kufi. Pjesët e fshehura në shkurre u montuan dhe varka ishte gati për t'u lëshuar në ujë. Ora ishte 10, por qetësia nuk kishte rënë ende në atë pjesë të liqenit. Të rinjtë që kishin ardhur në qytet për të bërë zborin ushtarak ishin rrotull vendit ku do të bëhej arratisja dhe po bënin zhurmë. Lëvizjet e të rinjve i bënë vëllezërit që të prisnin më gjatë për të vënë në zbatim planin e tyre. Në mesnatë ra qetësia. Ata filluan të mblidheshin rreth varkës. Pikërisht atëherë nga rruga u dëgjua e qara e një foshnje. Njëra nga nuset që mbante foshnjën ishte penguar dhe fëmija ishte trembur. Zëri u dëgjua edhe nga dy të rinj që po kalonin aty me biçikleta. Ata dyshuan se mund të ishte një fëmijë i braktisur.



Atëherë vëllai i madh doli në rrugë dhe u hoq si brigadier i fermës së qershive ndërsa vëllai i vogël, Et'hemi, si punëtor ferme:

- Jo, shoku brigadier nuk janë ata që kanë vjedhur qershitë, - tha vëllai i vogël.
- Po çfarë kërkojnë këtej me biçikleta? - pyeti vëllai i madh.

Dy të rinjtë u përpoqën që të sqaronin se nuk kishin vjedhur asgjë dhe se po kalonin andej teksa ktheheshin nga puna në minierë. Shumë shpejt u larguan. Vëllezërit morën frymë të lehtësuar që me rrengun e tyre ia kishin dalë të shmangnin një fatkeqësi. Nëse të rinjtë do të dyshonin sadopak, do të lajmëronin policinë dhe gjithë familja Fezollari **do të arrestohej**. Nuk guxonin ta mendonin se çfarë mund të ndodhte më pas.

Më në fund edhe dy vëllezërit iu bashkuan varkës që ishte futur disa metra në liqen për të mos rënë në sy të ndonjë kalimtari të natës.



PAS MESNATE

Në verë liqeni ishte i qetë, por atë mbrëmje një puhizë kishte krijuar pak dallgë duke e bërë më të vështirë udhëtimin. 16 jetë - 8 të rritur dhe 8 fëmijë lundronin drejt bregut tjetër të Ohrit, aty ku ishte një shtet tjetër dhe ku shpresonin që do të fitonin lirinë e munguar. Burrat rremonin, por dërrasat e përshtatura si rrema ishin të ashpra dhe ua çanë duart. Udhëtuan tetë orë. Teksa lundronin, hëna u shfaq dhe ndriçoi të gjithë liqenin, por për fatin e tyre të mirë, shumë shpejt një re e zuri dritën e saj dhe errësira u shtri në të gjithë sipërfaqen e ujit. Kur po zbardhej, panë bovat dhe e kuptuan se ishin shumë afër kalimit të kufirit ujqor. Numëruan sekondat derisa arritën në ujërat e huaja. Ishte po ai liqen, por tashmë i lirë. Ata rremuan deri në bregun tjetër. Aty më në fund këmbët u zunë tokë, tokë të lirë. **Kishin shpëtuar!** Përqaftuan njëri-tjetrin dhe puthën varkën e sajuar që i çoi gjallë.

NJË DITË MË VONË

Kur mbërritën në Jugosllavi, burrat e familjes dolën para gjyqit me akuzën e kalimit të paligjshëm të kufirit dhe u dënuan me 3 javë heqje lirie. Mbi ta nuk u nënshtroa dhunë dhe periudha e vuajtjes së dënimit ishte vetëm një kohë izolimi pa keqtrajtme, në përputhje me të drejtat e njeriut të parashikuara në ligjet ndërkombëtare. Ndërsa pjesa tjetër e familjes u strehua në një kamp pushimi. Udhëtimi i tyre për tetë orë nëpër liqen me një varkë të sajuar që mund të fundosej nga çasti në çast i bëri për vete të gjithë. Mediat e huaja transmetuan intervistat e familjarëve që tregonin për diktaturën në anën tjetër të liqenit. Pas disa javësh qëndrimi në Ohër, e gjithë familja u nis drejt Australisë, për t'u bashkuar me babanë. Atje morën **strehim politik**.

Ndërsa në Shqipëri diktatura përdoqi familjet e dy nuseve më të vogla të shtëpisë sepse bijat e tyre u arratisën. Ato u internuan dhe u burgosën. Të njëjtin fat patën edhe të afërm të tjerë të familjes Fezollari, të cilët u shpallën “armiq”.

PAS RËNIES SË DIKTATURËS

Familja Fezollari u rikthye në Shqipëri pas rënies së diktaturës. Dhanë kontributin e tyre dhe sot e kësaj dite bijtë dhe pasardhësit e tyre ndajnë jetojnë dhe punojnë në Shqipëri dhe në Australi.


DËSHMI

Bajram Fezollari ishte 16 vjeç kur ndodhi arratisja.

Ai kujton:

“Unë kam ikur në datën 2 korrik nga shtëpia dhe kam ndenjur me xhaxhain gjithë natën te vendi ku kishim fshehur pjesët e varkës. Sinjali për të komunikuar ishte një fishkëllimë. Kur u mbledhëm të gjithë, filluam të montonim varkën...

...Isha në mes të varkës dhe kur nxirrja dorën, prekja ujin. Nata ishte shumë e errët dhe kisha frikë. Liqenin mund ta shikoje edhe si dritë, por edhe si kuçedër që mund të merrte gjithë familjen tënde.”



Shpresa Fezollari, nusja e dytë e familjes Fezollari kujton:

"Momenti më i vështirë ishte kur doli hëna dhe e bëri dritë vendin, por për fatin tonë një re e zezë e zuri shpejt. Gjithashtu kur zbardhi dita, pamë se kishte akoma shenja të bardha në liqen. E kuptuam se nuk i kishim kaluar ujërat shqiptare. Burrat u dhanë rremave shpejt derisa dolëm në anën tjetër..."

...Më ka mbetur peng se kur u ktheva në Shqipëri nuk gjeta gjallë asnjë: as prindërit dhe as vëllanë që u internua për 4 vjet në Velçan sepse ne u arratisëm."

Qelibare Fezollari, nusja e vogël e familjes Fezollari kujton:

"Kishim shumë frikë kur ishim në varkë. Vajza qau dhe ia ulëm kokën poshtë që të pushonte. Kur zbritëm në anën tjetër të liqenit, puthëm varkën. Ajo na shpëtoi. Pastaj erdhën dy xhipa policie dhe na morën. Burrat i çuan në polici dhe neve na çuan në një kamp për dy javë. Prej aty shikonim Shqipërinë se na mori malli..."

Më vonë, dërgova një letër për familjen në Pogradec, por ma kthyen mbrapsht. Pastaj dërgova një letër tjetër, por më tha vëllai: "Mos më dërgo më, se vuajta 4 vjet në internim." Gjithë natën nuk fjeta. Edhe babain e internuan për shkak të arratisjes."

-HISTORIA 2-

ME NOT DREJT LIRISË

(mbështetur në dëshminë e Beqir Caushajt)

Kakomeja është një nga vendet më të bukura të bregdetit shqiptar. Por bukuria e tij fsheh edhe shumë histori të dhimbshme. Çfarë kanë parë gurët dhe deti pakkush e di! Njerëzit i rrëfejnë historitë që **të njihet e kaluara**.

TETOR 1987

Atë ditë vjeshte, dy të rinj të moshës 31 dhe 21 vjeç morën autobusin për të shkuar nga Tepelena në Delvinë. Rruga ishte e qetë, por mendjet e tyre ishin të shqetësuara. Prej kohësh kishin marrë një vendim që i mbante mes jetës dhe vdekjes. Kishin nisur një udhëtim, fundin e të cilit nuk e dinin.

Nuk i kishin thënë askujt për vendimin e tyre. Kishin folur vetëm me njëri-tjetrin. Edhe nga prindërit druhashin sepse nëse do t'i vinin në dijeni, atyre mund t'u shpëtonte goja dhe të thoshin ndonjë fjalë që mund ta dështonte të gjithë planin. Ndaj e diskutuan vetëm të dy, duke iu ruajtur edhe gurëve që të mos i dëgjonin.

DREJT DELVINËS

Autobusi ndiqte kthesat sikur të ishte duke u kapur pas malit me thonj. Beqiri rikthente edhe njëherë në mendje **të gjitha arsyet** që e kishin shtyrë për të marrë atë udhëtim tanimë pa kthim.

Familja e tij përndiqej nga Sigurimi i Shtetit sepse ata konsideroheshin “armiqtë e popullit”. Çdo fjalë dhe lëvizje e tyre ruhej dhe nuk do të ishte e largët dita kur policët do të shfaqeshin për t'i shqiptuar fjalët rrëqethëse: “Në emër të popullit je i arrestuar!”. Ishte një skenë që i dilte shpesh në ëndërr. Frika se çdo gjë mund të ndodhte, e ndoshta shumë më keq se kaq, e mbërtheu për një kohë të gjatë.



Derisa më në fund vendosi të fliste me shokun e tij. Prej kohësh diskutonin me zë të ulët dhe shumë larg të tjerëve për gjërat që nuk u pëlqenin: nuk ishin të lirë të thoshin atë që mendonin, **nuk ishin të lirë të lëviznin** ku të dëshironin. Nuk i kishin këto të drejta në vendin e tyre. Fatet e tyre ishin vulosur. Mbetej vetëm çështje kohe të mësonin se çfarë emri do të kishte vuajtja e tyre: burg, internim apo vdekje?



I zhytur në mendime, Beqiri nuk e vuri re se autobusi kishte mbërritur në Delvinë. Djemtë zbritën duke u hequr si udhëtarë që po shkonin për vizitë tek të afërmit e tyre. Kur u siguruan se askush nuk po i shihte, lanë pas rrugën kryesore dhe dalëngadalë shkuan drejt malit. Udhëtuan gjatë duke shmangur çdo rrugë apo shteg ku mund të kalonin njerëz. Muzgu kishte rënë dhe errësira pas pak do të mbështillte të gjithë malin. Tani rruga ishte më e sigurt. Nuk kaloi shumë kur dëgjuan të lehura qensh. Ishin qentë e staneve. Ata mund t'i shqyenin të gjallë nëse i kapnin. Lehjet e qenve u shtuan dhe të dy u ngjitën në majë të pemëve për të shpëtuar prej tyre. Zbritën vetëm kur u siguruan se qentë ishin larguar.

Nëse do të kishin zgjedhur që të arratiseshin nga Ksamili, nuk do të arrinin dot as deri tek bregu i detit. Sapo të kalonin Hotel Turizmin në Sarandë fshatarët do t'i pikasin dhe do të lajmëronin policinë. Atëherë ata do të kishin përfunduar në burg.

NË FSHEHTËSI TË PLOTË

Nga Kakomeja, ishulli i Korfuzit ishte më larg, por më pak i ruajtur nga forcat bregdetare apo nga banorët, sepse askush nuk mendonte se dikush mund të arratiset nga ajo distancë. Lehjet e qenve u dëgjuan sërish gjithnjë e më afër. Djemtë hipën edhe njëherë në pemë. Kur u siguruan se rreziku tashmë ishte larg, zbritën në tokë dhe vijuan rrugën e malit derisa mbërritën në kepin e Kakomesë. Atje zbritën poshtë dhe **u hodhën në det** nga një shkëmb. Ishte mesnatë.

Djemtë vazhdonin notin dhe mendonin se deri atëherë çdo gjë kishte shkuar më së miri. Kur një prozhektor i fortë ndriçoi sipërfaqen e ujit, të dy djemtë notuan në pozicionin mbrapsht dhe nuk lëvizën. Qëndruan ashtu derisa drita e fortë kaloi në zonën tjetër të detit. Të lehtësuar ata morën frymë thellë dhe vazhduan notin. Ishin ende larg, por ndonëse ishte tetor, deti ishte i qetë dhe uji i ngrohtë.

- Oh mos, - dëgjoi ai shokun e tij që rënkoi.
- Çfarë ka? - pyeti Beqiri.
- Më zuri ngërçi, - tha shoku.

I ishte bllokuar këmba dhe nuk mund të notonte më. Beqiri e ndihmoi duke e mbajtur sa t'i lirohej muskuli i këmbës. Pas disa minutash shoku i tij ishte qetësuar dhe të dy rifilluan të notonin, por tani më ngadalë për të shmangur një tjetër kontraktim muskujsh. Por koha nuk ishte krah tyre. Mëngjesi zbardhi shpejt dhe djemtë ishin ende në ujërat shqiptare. U duhej vetëm pak për të dalë në ujërat neutrale. Të dy bënë çmos që të notonin më shpejt pasi e dinin se drita nuk ishte aleatja e tyre dhe mund të pikaseshin nga çasti në çast. Notuan sa mundën, por ujërat neutrale dukej sikur largoheshin. Një moment panë se drejt tyre po vinte një anije.

NDALI

Menduan se po shpëtonin më në fund, por teksa anija afrohej, e kuptuan se bëhej fjalë për patrullë shqiptare. Djemtë e kuptuan se plani i tyre **për t'u arratisur** kishte dështuar.

Dëgjuan breshëritë e automatikëve dhe panë plumbat që u kaluan shumë pranë derisa u zhdukën në thellësinë e detit. Shpëtuan pa u vrarë. Anija tashmë ishte afruar dhe rojet i ngjithën të dy djemtë në kuvertë. Filluan t'i godisnin me shkelma dhe grushte derisa të dy u plandosën pa fuqi në kuvertë. Anija shtoi shpejtësinë dhe mbërriti në portin e Sarandës.

Të lidhur, djemtë u nxorën në sheshin e qytetit dhe shumë njerëz filluan t'i gjuanin me sende të ndryshme sepse ata konsideroheshin “armiqtë e popullit”. Pas këtij demaskimi u dërguan në hetuesi ku **u torturuan** fizikisht dhe psikologjikisht. Beqirin e mbajtën në qeli 6 muaj.

Në gjykatë seanca e zgjati vetëm pak minuta. Ai nuk kishte avokat mbrojtës. Beqiri u dënua me 22 vite heqje lirie, ndërsa shoku i tij me 21 vite burg. Akuza ndaj tyre ishte: tradhti e lartë ndaj atdheut. Beqir Caushaj e vuajti dënimin në burgun e Qafë-Barit nga i cili realizoi një tjetër arratisje të dështuar. Vetëm përpjekja e tretë do të rezultonte e suksesshme dhe do ta nxirrte atë në brigjet e Greqisë. Verën e vitit '90, arriti të hipte në anije, ashtu si shumë bashkëkombës të tij, për t'u larguar nga vendi. Më vonë Beqiri emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku jetoi si **qytetar i lirë**.

DËSHMI

**Beqir Caushaj, ish - i
dënuar politik sepse tentoi
të arratisesh, kujton:**

*"Kur po na dërgonin në Sarandë
për të na bërë gjyqin, dhe shikoja
se si disa njerëz na përbuznin,
mendoja me vete: Mjerë ne që na
kapën dhe mjerë ky popull që nuk
kupton ku jetojmë."*



-HISTORIA 3-

KRISMA NË GRAMOZ

(mbështetur në dëshminë e Luljeta Rrapos dhe dokumente të ish- Sigurimit të Shtetit)

MAJ-KORRIK 1990, SHQIPËRI

Era e demokracisë po frynte në të gjithë Evropën Lindore. Rënia e sistemit komunist në vendet e tjera nuk mund të mbetet pa mbërritur edhe në Shqipëri. Pas vdekjes së diktatorit Enver Hoxha, vendin e tij e zuri Ramiz Alia dhe u duk sikur diktaturës po i vinte fundi. Një ligj i datës 8 maj të vitit 1990 nuk e quante më arratisjen “**tradhti ndaj atdheut**”. Dënimi për kalimin e kufirit ishte “riedukim me punë ose burgosje deri në 5 vjet”. Sërish ishte një dënim i padrejtë, por askush nuk mund të vritej më si më parë. Kështu mendonte Safet Rrapo, djali 30-vjeçar i cili **ëndërronte** një jetë më të mirë dhe të lirë, larg diktaturës. Gjithë ato javë kishte bluar në mendje ikjen nga vendi. Një ditë të nxehtë korriku ai mësoi se shumë njerëz kishin kapërcyer muret dhe gardhet e ambasadave të huaja në Tiranë, për të kërkuar strehim politik. Njerëzit që donin të **largoheshin nga diktatura** tashmë ishin më të guximshëm dhe i kishin sytë tek ambasadat e huaja në Tiranë. Safeti shkoi një nga ato ditë në kryeqytet. Ai pa jo vetëm të rinj, por edhe familjarë që donin të hynin në ambasadë. Por policia shqiptare herë pas here kontrollonte Rrugën e Durrësit dhe shumë prej tyre fshiheshin nëpër hyrje pallatesh. Ashtu ishte fshehur edhe Safeti.

Pasi policia u largua, njerëzit grupe-grupe dolën dhe iu sulën mureve dhe hekurave që rrethonin ambasadat. Safeti u bë gati që të hynte në ambasadën gjermane, por pikërisht në atë çast policët shqiptarë u shfaqën befasisht me shkopinj gome dhe skafandra. Ai ndjeu një goditje të fortë në shpinë. Pastaj edhe disa të tjera. Njerëzit rreth e rrotull filluan të shpërndahen me vrap dhe të fshihen.

22 GUSHT 1990, ERSEKË

Safet Rrapo ishte përpjekur të futej në ambasadën gjermane, por nuk ia kishte dalë dot. Dhuna e policisë kishte marrë përpara atë dhe shumë të tjerë që mezi kishin pritur çastin e duhur për të kapërcyer muret. Ai u kthye në shtëpinë e tij në Ersekë. Familjarët e tij u shqetësuan teksa panë **shenjat e dhunës**.



Ditët kalonin dhe Safetin nuk e zinte vendi. Dëshira e tij për t'u larguar ishte bërë edhe më e fortë. Prej vitesh ëndërronte një jetë më mirë, të merrej me sport dhe modë, të ndiqte pasionet dhe dëshirat e tij në një vend ku askush nuk mund ta ndalonte. Meqenëse ligji për kufirin kishte ndryshuar, ai vendosi të kalonte nga mali i Gramozit për të shkuar në Greqi. Nëna u përpoq ta ndalonte si herët e tjera, por djali nuk hoqi dorë.

DREJT MALIT TË GRAMOZIT

Safeti doli të takonte shokët. Në restorantin e qytezës gjeti shokun e tij të fëmijërisë, dhe 3 të rinj të tjerë. Dy prej tyre që kishin ardhur nga Korça, po rrinin në hotelin e qytezës. Të rinjtë filluan të flisnin për arratisjen.

Në mesnatë të rinjtë u nisën drejt pikës kufitare të Rehovës. Nata ishte e ftohtë dhe me mjegull. Filloi shiu. Kur arritën në një lëndinë në qafë të malit të Gramozit, të rinjtë ndaluan për të pushuar dhe për të biseduar.

- Nëse do të na shohin ushtarët, do të shpërndahe mi në të dyja krahët, - tha njëri prej tyre.

Të tjerët miratuan dhe pas disa minutash u ngritën për të vazhduar udhëtimin drejt kufirit të ndaluar. Kaluan brezin e butë. **Kufiri** sa vinte dhe afrohej dhe të rinjtë po ecnin kur u dëgjua një zë: "Ndal!"

23 GUSHT, ORA 3 E MËNGJESIT

Atë natë, në qytezë, u dëgjua krisma armësh që vinin nga mali. Familja e Safetit mendoi se diçka duhet të kishte ndodhur patjetër. Ai nuk ishte në shtëpi, por ata mendonin se ishte me shokët. Të nesërmen trokitje të forta në derën e shtëpisë çuan peshë familjen. Ishte **policia**. Kërkonte të dinte ku ishte Safeti. Por askush nuk dinte asgjë. Këmbëngulja e policëve i bëri familjarët që të mendonin se ndoshta djali i shtëpisë kishte zbatuar tashmë planin e tij për t'u arratisur.

Filluan ta kërkonin në malin e Gramozit, aty ku mendonin se duhet të kishte ikur. Për pesë ditë, babai, vëllai dhe motrat kërkuan për djalin, por nuk e gjetën që nuk e gjetën dot.

NJË DITË MË VONË

Një çoban erdhi në shtëpinë e tyre për t'i lajmëruar që e kishin gjetur djalin. Me një trazirë në shpirt Luljeta dhe vëllai i saj shkuan drejt vendit ku ishin ushtarët. Mes trupave të tjerë të pajetë, ajo njohu të vëllain e hedhur mbi një turrë drush. Rojet e futën në një thes dhe e ngarkuan në makinë.

Merre! – i tha ushtari.

Luljeta zuri të thërriste nga **dhimbja**. Bota u shemb për familjen Rrapo.

DEGA E PUNËVE TË BRENDSHME

Zyrtari i policisë po mbyllte komunikatën operative 202. I kishin mbetur që të shkruante edhe 3 raportime nga Tropoja, Gjirokastra dhe Erseka. Ndryshe nga njoftimet e tjera, këto të fundit ishin vetëm për arratisje. Një ditë më parë dy të rinj, 14 dhe 15 vjeç, ishin kapur në kufi ndërsa **pengesa elektrosinjaluze** në fshatin Katund të Gjirokastrës kishte sinjalizuar për një kalim të kufirit. Mendohej se ishin një ose dy vetë që ishin arratisur drejt shtetit fqinj. “Sa shumë arratisje po ndodhin këto muaj”, mendoi teksa shtypte në makinën e shkrimit. I kishte mbetur për të shkruar edhe rastin e Ersekës kur lexoi me kujdes atë që ishte dërguar.

“Më datën 27.08.1990 në malin e Gramozit, në postën kufitare Rehovë, u gjet kufoma e Safet Irfan Rrapos, vjeç 30, shofer, i cili së bashku me 5 persona të tjerë, disa ditë më parë, ka tentuar të kalojë kufirin, por është rrëzuar nga shkëmbi.”

Ky ishte raportimi i fundit që mbylli komunikatën nr. 202 të datës 28 gusht 1990.

DITA E ZISË

Askush nuk shkoi për ngushëllim në shtëpinë e Safet Rrapos. Rojet dhe spiunët qëndronin para shtëpisë ndaj njerëzit të frikësuar qëndronin larg. Djali u përcoll në varreza vetëm nga familja e tij që u detyrua të shmangte rrugën kryesore të qytetit. Të gjithë i ndiqnin nga dritaret, por nuk guxonin të dilnin në rrugë. Edhe në varreza, familja ruhej nga spiunët e Sigurimit.

E VËRTETA

E vërteta e natës së 23 gushtit 1990 kishte filluar të zbardhej pas ardhjes së demokracisë, kur familja e tij kishte kërkuar të zbulonte se çfarë kishte ndodhur me Safetin. Ndërsa në dosjet e Sigurimit të Shtetit, ngjarja në pikën kufitare të Rehovës do të dokumentohej me raporte të shumta.

Tretërinj u vranë me armë nga njësitë kufitar. Safeti, në përpjekje për t'i shpëtuar plumbave, ishte rrëzuar nga një lartësi 7 metra duke përplasur kokën në një shkëmb. I vetmi që shpëtoi nga shokët, u kap nga ushtarët ditën e 23 gushtit. U arrestua dhe u dënua me 4 vite burg për kalim të paligjshëm kufiri.





DËSHMI

**Luljeta Rrapo, motra e Safet
Rrapos kujton:**

“Të nesërmen e varrosëm vëllain. Edhe në varreza kishin futur spiunë dhe na përgjonin. Ne ishim të nxehura dhe thoshim që do të merrnim hakun e vëllait. Për ato fjalë ata na thirrën në punë dhe na pushuan nga puna.»”

KE DËGJUAR PËR NJË HISTORI ARRATISJEJE NË KOHËN E DIKTATURËS ? SHKRUAJE HISTORINË KËTU!

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Nëse dëshiron të ndash historinë tënde me të tjerë, kërkuj të rriturve ose mësuesve që ta dërgojnë historinë që ke shkruar në adresën info@autoritetidosjeve.gov.al

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

MËSOJMË NGA E KALUARA

Diktatura dhe e drejta e lëvizjes së lirë

Mohimi i të drejtave themelore të njeriut nga regjimi komunist i **detyronte** shqiptarët, të cilët ishin kundër diktaturës, që të linin vendin. Por dalja nga Shqipëria ishte e pamundur pasi **lëvizja e lirë** e qytetarëve ishte e ndaluar. Kufijtë shtetërorë ishin mbyllur dhe askush nuk mund të kalonte jashtë tyre. Dalja jashtë shtetit ishte privilegj vetëm për një kategori të caktuar njerëzish.

Kështu e drejta themelore e njeriut, ajo e lëvizjes së lirë nuk njihet dhe shkelet nga diktatura. Për qytetarët, jeta të cilëve ishte në rrezik, e vetmja mënyrë **shpëtimi** ishte arratisja, apo ndryshe kalimi i kufirit në mënyrë të fshehtë. Këtë veprim ligjet e diktaturës e konsideronin **tradhti ndaj atdheut**, krim kundër shtetit dhe çdo person që kapej në tentativë për të kaluar kufijtë e ndaluar, dënohej mbi 10 vjet BURG ose dhe dënim me **vdekje**.



Neni 47

Tradhtia ndaj Atdheut është krimi më i rëndë që mund të kryejë shtetasi i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Tradhti ndaj Atdheut quhet çdo vepër e kryer për të përmbysur shtetin e diktaturës së proletariatit, si dhe çdo vepër të drejtuar kundër pavarësisë kombëtare, fuqisë mbrojtëse dhe sigurimit të jashtëm të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, siç janë sidomos:

...gj) arratisja jashtë shtetit, si edhe refuzimi për t'u kthyer në Atdhe i personit që është dërguar me shërbim ose është lejuar përkohësisht të shkojë jashtë shtetit.

Tradhtia ndaj Atdheut DËNOHET me heqje të lirisë jo më pak se DHJETË VJET ose me VDEKJE dhe kurdoherë me konfiskim të pasurisë.

(Neni 47 pika "gj" e Kodit Penal shqiptar të vitit 1977)

Rojt kufitare mund të hapnin zjarr dhe të qëllonin kundër çdo personi që hynte apo dilte në kufijtë shqiptarë edhe nëse ata nuk ishin të armatosur. Si dikur, edhe sot, **vrasja nga shteti** e njerëzve që tentojnë të kalojnë kufirin, pavarësisht qëllimit, është **e paligjshme** dhe shënon **shkelje të të drejtave të njeriut** dhe konventave ndërkombëtare që i mbrojnë këto të drejta.

Më 8 maj 1990, disa muaj pas rënies së murit të Berlinit dhe ndryshimeve demokratike në vendet ish-komuniste të Europës Lindore, regjimi diktatorial në Shqipëri vendosi që arratisjen të mos e cilësonte më tradhti ndaj atdheut. Ai hoqi dënimin me vdekje. Të gjithë menduan se diktatura ishte zbutur dhe iu drejtuan kufijve për të shkuar në vende të tjera për një jetë të lirë. Por ndryshimi i ligjit mbeti vetëm në letër dhe për pasojë në vitin 1990 ndodhën shumë vrasje në kufirin shqiptar.



Arratisje në shifra

Rreth 13600 persona u numëruan të arratisur në raportet e Sigurimit të Shtetit, nga 1944 deri në vitin 1990. Nga këta, rreth 4 784 ishin gra dhe fëmijë.

Rreth 998 persona vdiqën ose u vranë nga regjimi në përpjekje për të kaluar kufirin.

Rreth 4 790 vetë mendohet se janë arratisur përmes ambasadave të huaja më korrik 1990 në Tiranë.

Me izolimin e vendit dhe dhunën që ushtrohej ndaj njerëzve që tentonin të arratiseshin, regjimi komunist shkeli:

- Të drejtën për jetën.
- Të drejtën për lëvizje të lirë.
- Të drejtën për strehim politik.



Neni 3

Çdo njeri ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.

(Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut)

Neni 13

1. Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe të banimit brenda kufijve të çdo shteti.

2. Çdo njeri ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

(Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut)

Neni 14


1. Çdo njeri ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.

2. Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

(Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut)

“Arratisja jashtë shtetit, sipas diktaturës”

Pjesë nga “Baza teorike kapitulli mbi arratisjet” (arkivi i AIDSSH)




Disa arsye të arratisjes nga diktatura

1. Disa ishin të DETYRUAR që të arratiseshin sepse kishin bindje politike të ndryshme nga regjimi dhe përndiqeshin për shkak të këtyre bindjeve. E DREJTA E LIRISË SË MENDIMIT DHE SHPREHJES ISHTE **SHKELUR**.
2. Kishte nga ata që mund të dënoheshin përsëri dhe të përballeshin edhe me rrezikun për humbjen e jetës ndaj ishin të detyruar që të arratiseshin për të shpëtuar nga persekutimi i vazhdueshëm. E DREJTA PËR JETËN ISHTE **SHKELUR**.
3. Disa mund të ishin keqtrajtuar dhe torturuar për arsye politike dhe kërkonin shpëtim duke u arratisur nga vendi. E DREJTA E TYRE PËR TË MOS IU NËNSHTRUAR TORTURAVE DHE DHUNËS ISHTE **SHKELUR**.

4. Dikush ishte i detyruar të largohej sepse i afërmi i tij ishte armik i popullit dhe për pasojë edhe ai do të dënohej nga regjimi si armik. E DREJTA PËR TË MOS U DISKRIMINUAR ISHTE **SHKELUR**.
5. Disa detyroheshin të arratiseshin sepse i trajtonin si armiq të popullit, i linin pa punë, pa shkollë dhe pa ushqim duke i zhytur në varfëri. TË DREJTAT E ARSIMIT DHE PUNËS ISHIN **SHKELUR**.
6. Disa mund të arratiseshin sepse kishin informacion që jeta jashtë kufijve të Shqipërisë ishte më e mirë dhe e lirë. E DREJTA PËR TË LËVIZUR I LIRË ISHTE **SHKELUR**.

Fragment nga një dokument i ish-Sigurimit të Shtetit (arkivi i AIDSSH)



Kufij të mbyllur

Kufiri i Shqipërisë është i gjatë 1094 kilometra. Pas Luftës së Dytë Botërore vendi filloi të izolohej nga bota e jashtme. Kufiri tokësor u rrethua me tela me gjemba dhe forca të armatosura ndërsa në kufijtë ujorë u vendosën shenja ndriçuese.

Kufiri ruhej nga Forcat e Kufirit, Sigurimi i Shtetit dhe policia. Zonat kufitare patrulloheshin gjatë gjithë kohës. Për të shkuar në këto zona duhet të merrje leje. Sipas rregullores forcat e kufirit mund të hapnin zjarr ndaj çdo civili apo ushtaraku që tentonte të arratisëj nga Shqipëria. Çdo ushtar i kufirit që arrinte të kapte ose qëllonte një person që kërkonte të arratisëj, shndërrohej në një hero për propagandën komuniste.



Si ruhej kufiri tokësor?

- *Piramidat që vendoseshin në vijën ndarëse mes dy vendeve dhe në largësi nga njëra tjetra përgjatë kufirit rreth 2 km.*
- *Klone që shtriheshin në distancë 500 metër nga piramida dhe vija kufitare. Kloni ishte një pengesë me tela elektro-sinjalizuese rreth dy metra të lartë që mbështetej në shtylla betoni.*
- *Ngjitur me klonin ishte brezi i butë, një rrip toke i punuar me gjerësi rreth 5 metra, kalimi nëpër të cilin, ishte i pamundur pa lënë gjurmë.*
- *Brezi kufitar, që ishte i shtrirë si shirit në gjithë gjatësinë e kufirit tokësor, në gjerësi 1.5 km, në të cilin lejoheshin vetëm ushtarët dhe forcat e Sigurimit.*

Kush quhej armik?

Kuptimi i fjalës “armik” në ditët e sotme është **“kundërshtari në luftë, ose ai që urren dikë dhe përpiqet që t’i bëjë keq”**. Gjatë regjimit totalitar, kjo fjalë kishte një ngjyresë politike. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1980 fjala “armik” shpjegohej si personi që **“është kundër interesave të klasës, të Partisë, të atdheut, të socializmit dhe që lufton e vepron kundër tyre”**.

Armiku ndëshkohej me të gjitha mënyrat, që nga diskriminimi deri tek dënimi me burg, internim apo vdekje. Armiku i klasës apo i popullit kërkohesh kudo, për shembull te: politika, feja, ekonomia, arti, sporti, ushtria etj., pra në të gjitha fushat e jetës.

Në të gjitha rastet armiku i popullit sipas regjimit duhej **eliminuar**. Përcaktimi “armiq të popullit” njihet nga studiuesit si një nxitje e drejtpërdrejtë për dhunë, për veçim dhe poshtërim. Kjo mendësi propagandohej që në shkolla për të nxitur luftën e klasave edhe tek brezi i ri.



Fshatarët e pasur që zotëronin toka dhe shiheshin si kundërshtarë të reformave të regjimit në bujqësi dhe në blegtori quheshin me termin përbuzës, kulakë. Këtyre njerëzve u merrej prona, paratë dhe gjithcka që kishin. Ata gjithashtu dënoheshin me burg si armiq.

Internim kolektiv

Familjarët e personave që arratiseshin vuanin **pasoja** të rënda. Ata dënoheshin me internim kolektiv, që do të thotë se e gjithë familja dërgohej në kampet e internimit. Për çdo rast arratisjeje, të dështuar apo të suksesshme, pasojat për familjarët dhe të afërmit ishin të pashmangshme pavarësisht nëse ata ishin përfshirë apo jo në “krimin” e kryer nga personi i arratisur. Ndërkohë, internimi i familjeve të kundërshtarëve politikë të regjimit kishte nisur që në vitin 1949. Në të gjitha rastet, familjet e të arratisurve apo të dënuarve politikë i nënshtroheshin diskriminimit shoqëror në të gjitha format.



Në dekretin e vitin 1979, me një në internim kolektiv mund të dërgoheshin edhe pjesëtarë të familjes së personave të arratisur brenda ose jashtë shtetit.

Sipas ligjit “pjesëtarë të familjes” quheshin “bashkëshorti, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, si dhe persona të tjerë që bashkëjetonin me të dhe kanë qenë në ngarkim të tij”.

Lufta e klasave

Lufta e klasave ishte një nga shtyllat kryesore të regjimit komunist që ishte vendosur në vendet e Europës Lindore dhe në Shqipëri. Shoqëria shikohej e ndarë në klasa, të cilat ishin në konflikt të vazhdueshëm me njëra-tjetrën, pra klasa e pasur dhe klasa e punëtorëve ose proletariati. Ky i fundit përfaqësohej nga partia e tij, në vendin tonë Partia e Punës dhe synonte ndryshimin e sistemit të vjetër qeverisës dhe shoqëror. Regjimi komunist propagandonte se lufta e klasave do të sillte barazi, por në të vërtetë ajo solli përçarje, dhe shkëlqe të të drejtave të njeriut duke i shërbyer forcimit të diktaturës.

Në Shqipëri, me luftën e klasave, diktatura synonte **zhdukjen** e kundërshtarëve politikë, klasave të pasura, tregtarëve, pronarëve të tokës, shërbimeve, industrisë në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore. Goditja ndaj tyre ishte eliminim fizik, burgosje dhe internim, nënshtrim, përjashtim dhe persekutim i të gjithë atyre individëve apo grupeve shoqërore që nuk mbështesin sistemin komunist.

Lufta e klasave shkaktoi **përbuzje** dhe **urrejtje** midis njerëzve në komunitet, madje edhe brenda një familjeje apo fisi.



Disa vite pas vendosjes së regjimit totalitar, pre e luftës së klasave do të binin edhe njerëz të cilët ishin pjesë të partisë dhe ideologjisë së saj, ose që ishin intelektualë të formuar në shkolla të huaja në vendet që i përkisnin kampit komunist ku Shqipëria bënte pjesë. Edhe ata u shpallën ARMIQ dhe iu nënshtruan dënimeve me burg ose me vdekje.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rrozhani, Rovena

Kufij të thyer : 3 rrëfime për lirinë : një botim
për ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare / Rovena

Rrozhani ; Il. Anila Zajmi-Katanolli ; red. Elona

Baçi. - Tiranë : AIDSSH, 2024.


42 f. : me il. ; 17.6x25 cm.

ISBN 9789928480125


1.Arratisja 2.Sundimi komunist, 1945-1990
3.Kujtime 4.Tekste mësimore 5.Shqipëri

323.281(496.5) (075)

ISBN 9789928480125



9 789928 480125 >



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETETIT